
VLERËSIM I PAJTUESHMËRISË: PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE

Enso Shqipëri (Projekti i IFC #30979)

Shqipëri

Më 28 shtator 2011, IFC miratoi një investim kapitali në fazë të hershme deri në 6 milionë euro për Enso Hidro Energji sh.pk, një kompani shqiptare "holding" e themeluar nga Enso Hidro GmbH (referuar bashkërisht si "Enso" ose "klienti"). Enso Hydro GmbH është një kompani austriake e specializuar në investime për projekte hidrocentralesh në shkallë të vogël dhe të mesme. Ky vlerësim i pajtueshmërisë ka të bëjë me një projekt hidrocentrali prej 8.9MW me bazë rrjedhën e lumit i përgatitur nga klienti, që do të ngrihet mbi lumin Lëngaricë ("projekti").

Më 22 qershor 2015, CAO ka marrë një ankesë të paraqitur nga Shoqata e Bujqësisë Organike. Ankuesit pretendojnë se projekti shtrihet brenda kufijve të Parkut Kombëtar Bredhi i Hotovës. Ankesa pretendon shkelje të standardeve mjedisore dhe sociale (M&S) të IFC-së, ku përfshihen: mosrespektimi i legjislacionit kombëtar; mospërmbushja e detyrimit për mbrojtjen dhe ruajtjen e habitateve natyrore dhe kritike; përfshirja e pamjaftueshme e komunitetit; dhe ndikimet negative në jetesën e bazuar tek turizmi.

Qëllimi i vlerësimit të pajtueshmërisë është që të garantojë që hetimet e pajtueshmërisë të nisen vetëm për ato projekte që ngrenë shqetësime të konsiderueshme në lidhje me rezultatet e tyre mjedisore dhe/apo sociale, dhe/apo çështje të rëndësishme sistemike të IFC / MIGA.

Është pranuar që vendndodhja e këtij projekti është në një park kombëtar. Është pranuar gjithashtu që projekti do të zhvillohet/ndërtohet në një zonë me vlera të larta biodiversiteti dhe habitate të pasura. Për më tepër, në zonën e projektit është identifikuar një specie e përfshirë në Listën e Kuqe (rrezikuar në nivele kritike) të Bashkimit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (BNRN), *Anguilla anguilla* (ngjala europiane).

Habitatet natyrore, habitatet kritike dhe zonat e mbrojtura përfitojnë mbrojtje të posaçme në baze të Standartit të Ekzekutimit No. 6 (Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Burimeve Natyrore të Qëndrueshme). Në këtë kontekst, CAO vë në dukje pikëpamjen e IFC-së se projekti nuk do të ndikojë në habitatet kritike dhe nuk është i vendosur në një zonë të mbrojtur me ligj për qëllime të mbrojtjes apo ruajtjes së biodiversitetit. CAO gjithashtu vë në dukje pikëpamjen e IFC-së se projekti/vepra është projektuar në mënyrë të tillë që minimizon ndikimet negative në biodiversitetin dhe terrenet lokale me rëndësi nga pikëpamja e trashëgimisë kulturore dhe skenike.

Megjithatë, CAO konstaton se ankesa ngre probleme të rëndësishme që lidhen me vlerësimin dhe mbikëqyrjen e ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit nga ana e IFC-së. Këto përfshijnë:

- a. Nëse shqyrtimi para-investimor i standardeve M&S të projektit nga ana e e IFC-së, dhe sidomos shqyrtimi i ndikimit të tij të mundshëm mbi biodiversitetin dhe shërbimet e ekosistemit ishte proporcional me rrezikun.
- b. Nëse IFC siguroi zbatimin e përshtatshëm të Standartit të Ekzekutimit No. 6 për këtë projekt, sidomos po të mbahet parasysh vendndodhja e projektit në një park kombëtar dhe prania e specieve të rralla dhe/apo të rrezikuara në këtë zonë; dhe
- c. Nëse IFC siguroi zbatimin e përshtatshëm të standardeve të saj të konsultimit dhe të informimit për projektin.

Zgjidhja e problemeve të mësipërme kërkon marrjen në konsideratë në mënyrë të hollësishme dhe përfshirjen e ekspertizës teknike përkatëse. Si rezultat, CAO ka identifikuar nevojshmërinë e kryerjes së një hetimi të pajtueshmërisë. Termat e referencës të hetimit të pajtueshmërisë do të përgatiten në përputhje me Udhëzimet Operative të CAO.

Information mbi CAO

Misioni i CAO është që të shërbejë si një mekanizëm i pavarur, i drejtë, i besuar, dhe efektiv për ankim dhe për të përmirësuar përgjegjshmërinë mjedisore dhe sociale të IFC dhe MIGA.

CAO (Zyra e Avokatit të Popullit Këshilltar për Pajtueshmërinë) është një post i pavarur që i raporton drejtpërdrejt Presidentit të Grupit të Bankës Botërore. CAO shqyrton ankesat nga komunitetet e prekura nga projektet e zhvillimit të ndërmarra nga të dy krahët e sektorit privat të Grupit të Bankës Botërore, Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) dhe Agjencia për Garantimin e Investimeve Shumëpalëshe (MIGA).

Për më shumë informacion në lidhje me CAO, ju lutemi vizitoni www.cao-ombudsman.org.

Pasqyra e Lëndës

I.	Vështrim i përgjithshëm mbi procesin e Vlerësimit të Pajtueshmërisë	5
II.	Sfond	6
	Investimi	6
	Ankesa	6
	Pikëpamja e Kompanisë	7
III.	Analizë	7
	Shqyrtimi para-investimor	8
	Zbatimi i Standartit të Ekzekutimit No. 6	10
	Informimi dhe angazhimi i palëve të interesuara	11
	Pajtueshmëria me legjislacionin kombëtar	12
	Konkluzion.....	12
IV.	Vendimi i CAO.....	12

I. Vështrim i përgjithshëm mbi procesin e Vlerësimit të Pajtueshmërisë

Kur CAO merr një ankesë në lidhje me një projekt të IFC apo MIGA, ankesa referohet për vlerësim. Nëse CAO arrin në përfundimin se palët nuk janë të gatshme apo të aftë për të arritur një zgjidhje të ndërmjetësuar, dosja transferohet tek zyra e pajtueshmërisë në CAO për vlerësim dhe hetimet e nevojshme.

Një vlerësim pajtueshmërie mund të fillohet nga zëvendës-presidenti i CAO, drejtuesit e IFC/MIGA, apo nga kryetari i Grupit të Bankës Botërore.

Fokusi i zyrës së pajtueshmërisë në CAO është tek IFC dhe MIGA, dhe jo tek klienti i tyre. Kjo vlen për të gjitha aktivitetet e biznesit të IFC-së, duke përfshirë sektorin e pasurive të paluajtshme, tregjet financiare dhe veprimtarinë këshilluese. CAO vlerëson se si IFC/MIGA sigurohet për kryerjen në mënyrë të përshtatshme të veprimtarisë së saj të biznesit apo veprimtarisë këshilluese, si dhe nëse rezultatet e aktivitetit të biznesit apo veprimtarisë këshilluese janë në përputhje me qëllimin e dispozitave përkatëse të politikave. Megjithatë, në shumë raste të vlerësimit të ekzekutimit së projektit dhe zbatimin nga ana e MIGA/IFC të masave për zbatimin e standardeve përkatëse, del e nevojshme që CAO të shqyrtojë veprimet e klientit dhe të verifikojë rezultatet në terren.

Për të vendosur nëse një hetim i pajtueshmërisë është i nevojshëm, CAO kryen paraprakisht një vlerësim të pajtueshmërisë. Qëllimi i procesit të vlerësimit të pajtueshmërisë është për të siguruar që hetimet e pajtueshmërisë të nisen vetëm për ato projekte që ngrenë shqetësime të konsiderueshme në lidhje me rezultatet mjedisore dhe/ose sociale, dhe/ose probleme të rëndësishme sistematike të IFC / MIGA.

Në kryerjen e procesit të vlerësimit të pajtueshmërisë, CAO zbaton disa kritere bazë. Këto kritere testojnë vlerën e kryerjes së një hetimi të pajtueshmërisë, ndërkohë që CAO kërkon të përcaktojë nëse:

- Evidentohen rezultate potencialisht shumë negative mjedisore dhe/apo sociale tani apo në të ardhmen.
- Ka gjasa që një politikë ose kritere të tjera të vlerësimit të mos jenë respektuar apo zbatuar në mënyrë të përshtatshme nga IFC/MIGA.
- Evidentohet se dispozitat e IFC/MIGA-së, pavarësisht nëse janë përmbushur apo jo, nuk kanë arritur të sigurojnë një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje.

Në kryerjen e vlerësimit, CAO do të bashkëpunojë me ekipin e IFC/MIGA që punon me projektin specifik dhe palë të tjera të interesuara për të kuptuar se cilat kritere janë përdorur nga IFC/MIGA për t'u siguruar në lidhje me ekzekutimin e projektit, në ç'mënyrë është siguruar IFC/MIGA në lidhje me pajtueshmërinë me këto kritere, në ç'mënyrë është siguruar IFC/MIGA nëse këto dispozita garantojnë një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje, dhe, në përgjithësi, nëse një hetim i pajtueshmërisë është masa e përshtatshme. Pas kryerjes së vlerësimit të pajtueshmërisë, CAO mund të vendosë t'a mbyllë çështjen, ose të fillojë një hetim të pajtueshmërisë të IFC apo MIGA.

Mbas përfundimit të vlerësimit të pajtueshmërisë, CAO informon me shkrim IFC/MIGA, Presidentin e Grupit të Bankës Botërore dhe Bordin. Nëse vlerësimi i pajtueshmërisë rezulton nga një çështje e transferuar nga zyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve e CAO, njoftim me shkrim do t'i bëhet edhe ankuesit. Përmbledhja e rezultateve të vlerësimit do të bëhet publike. Nëse mbas kryerjes së vlerësimit të pajtueshmërisë CAO vendos të fillojë një hetim të pajtueshmërisë, CAO harton termat e referencës për hetimin e pajtueshmërisë në përputhje me Udhëzimet Operative të CAO.

II. Sfond

Investimi

Më 28 shtator 2011, IFC miratoi një investim kapitali në fazë të hershme deri në 6 milionë euro për Enso Hidro Energji sh.pk, një kompani shqiptare "holding" themeluar nga Enso Hidro GmbH (referuar bashkërisht si "Enso" ose "klient").

Investimi i IFC-së ishte për kapital deri në shumën 6 milionë euro, që pasqyron deri në njëzet për qind të kapitalit të papaguar të aksioneve të klientit. Qëllimi i investimit ishte mbështetja e ndërtimit të projekteve të hidrocentraleve në Lëngaricë dhe Mat, si dhe projekteve të tjera të parashikuara për të ardhmen. Në 3 shkurt 2012, klienti dhe IFC nënshkruan një marrëveshje për investim dhe më 11 mars, 2013 IFC ka realizuar investimin. Investimi është klasifikuar si Kategori B, që do të thotë se IFC ka gjykuar se rreziqet dhe ndikimet e mundshme M&S janë të kufizuara.

Projekti i hidrocentralit të Lëngaricës është një projekt hidroenergjetik 8.9MW i tipit me bazë rrjedhën e lumit, që ndërtohet nga një filial i kontrolluar nga klienti.

Projekti është ndërtuar në pjesën e poshtme të shtratit të lumit Lëngaricë, një degë e limit të Vjosës, në rrethin e Përmetit, prefektura Gjirokaster, Shqipëri. Projekti përbëhet nga një rregullator, një tunel 4 km, një rezervuar, një portal uji 3.7 km, një central elektrik, dhe një linjë transmetimi prej 6.5 km që lidhet me nënstacionin e Përmetit. Projektit iu dha një konçesion ndërto-shfrytëzo-transfero (NShT) prej 35 vjetësh nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Shqipërisë në vitin 2008. Në qershor 2011, Enso paraqiti një kërkesë për leje mjedisore, e cila u refuzua në tetor 2011. Më pas, Enso iu dha leja në janar 2012, pas paraqitjes së informacionit shtesë. Projekti Lëngaricë ka qenë në funksionim që nga nëntori 2015.

Ankesa

Më 22 qershor 2015, Shoqata e Bujqësisë Organike paraqiti pranë CAO-s një ankesë në emër të popullatës së prekur nga projekti. Më 15 korrik 2015, CAO vendosi se ankesa ishte e drejtë. Pas një përpjekjeje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, në shkurt 2016 ankesa është transferuar për shqyrtim në zyrën e pajtueshmërisë të CAO.

Sipas ankuesve, projekti është i vendosur brenda një parku kombëtar që është përcaktuar si zonë e mbrojtur dhe rregullohet nga legjislacioni kombëtar që ndalon aktivitetet me ndikim të lartë në ato zona. Për këtë arsye, ata e shohin ndërtimin e projektit si shkelje të legjislacionit shqiptar dhe kanë shprehur shqetësim për precedentin që mund të krijohet në lidhje me projektet e ardhshme në zonat e mbrojtura. Ata kanë ngritur pyetje në lidhje me lejet e marra nga Enso Shqipëri, dhe për studimet e ndikimit social dhe mjedisor, të cilat u financuan nga kompania.

Ankuesit e konsiderojnë shtratin e lumit Lëngaricë, ku është i vendosur projekti, si një zonë unike dhe të pasur me biodiversitet që mbështet disa komunitete, kulturën e tyre, dhe aktivitetet e tyre ekonomike. Ankuesit besojnë se veprimtaria e eko-turizmit, që është një aktivitet jetese, do të ndikohet negativisht nga ndërtimi i projektit. Ata shprehin shqetësim të veçantë në lidhje me devijimin e ujërave të lumit, gjë që sipas tyre do të ndikojë tek biodiversiteti, qasja dhe mundësia e përdorimit të ujit nga ana e popullatës, si dhe tek peisazhi natyror (lumi vetë, burimet termike, kanioni dhe shpella e Bënjës, Guri i Petranit, dhe monumente të tjera natyrore,

të cilat kanë vlera kulturore dhe turistike). Ata shprehen se për arsye të projektit, vetëm 2.5 për qind e rrjedhës së lumit do të mund të ndjekë rrjedhen e saj të natyrshme.

Megjithëse kompania zhvilloi takime me komunitetet, ankuesit pretendojnë se ajo nuk i ka trajtuar në mënyrë të përshtatshme problemet lokale apo kundërshtimet ndaj projektit, të cilat ishin paraqitur nga anëtarët e komunitetit. Ankuesit gjithashtu besojnë se projekti ka bërë pak në lidhje me krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e infrastrukturës, apo përfitime të tjera lokale.

Pikëpamja e Kompanisë

Siç përmbledhet në Raportin e Vlerësimit të CAO¹, kompania shprehet se ka treguar kujdesin e duhur në lidhje me projektin e Lëngaricës. Ata shprehen se konçesioni është dhënë para se zona të njihej si park kombëtar dhe se zona e mbrojtur (zona qëndrore) e parkut është rreth 9 km larg nga zona e projektit. Ata shprehen se projekti është projektuar në shkallë të vogël dhe shumë të padukshme, me 95 për qind të ndërtimit nën tokë, dhe me ndikime të kufizuara mjedisore. Kompania deklaron se ka trajtuar problemet e ngritura nga palët e interesuara në nivel lokal, siç janë ndikimet në burimet termike, qasja tek uji, dhe ndikimim mbi turizmin, nëpërmjet kryerjes së studimeve apo punimeve në vend për të trajtuar këto çështje, për shembull, me anë të një plani rehabilitimi për të restauruar zonën, ndërtimin e një kalimi për peshqit, dhe rehabilitimin e monumenteve të kulturës. Ata raportojnë se studimet e kryera, që nga Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe deri tek një hetim nga Ministria e Mjedisit, kanë arritur në përfundimin se ndikimet mjedisore nga projekti janë të kufizuara ose nuk ekzistojnë.

Përsa i përket legjislacionit kombëtar, kompania pranon se është e vërtetë që disa pjesë të projektit bien në një park kombëtar, por se parku ka përcaktuar zonat ku disa aktivitete janë të lejuara, dhe ata besojnë se projekti është në këto zona. Ata theksojnë se ky projekt ka një liçencë të vlefshme mjedisore të lëshuar në janar 2012.

Për sa i përket konsultimeve me komunitetin, kompania pretendon se ka organizuar takime publike dhe sesione informuese, dhe se ka ftuar OJQ-të, palët e prekura, dhe palë të tjera të vizitojnë faqen e internetit të projektit dhe të paraqesin shqetësimet e tyre. Ata raportojnë se këto veprime kanë patur efekt të kufizuar. Sipas tyre, projekti dhe aktivitetit ekonomik që ai ka sjellë në këtë zonë kanë mbështetjen lokale.

III. Analizë

Investimi i IFC-së tek klienti është realizuar në bazë të politikës së saj të vitit 2006 për Qëndrueshmërinë Sociale dhe Mjedisore ("Politika e Qëndrueshmërisë") dhe Standardet e Ekzekutimit (SE), së bashku të referuara si Struktura e Qëndrueshmëria. Këtu aplikohet edhe Politika e IFC-së të vitit 2006 për informimin.

Ky seksion shqyrton efektshmërinë M&S të IFC-së në bazë të standardeve të mësipërme. Duke patur parasysh çështjet e ngritura nga ankuesit, ai përqendrohet në:

- (a) Shqyrtimin para-investimor të standardeve M&S të projektit nga ana e e IFC-së, dhe nëse ishte proporcional me rrezikun.

¹ Raporti i Vlerësimit të CAO, Enso Shqipëri-01 Nëntor 2015 - <http://goo.gl/CfFd0g>

- (b) Zbatimin e përshtatshëm nga ana e e IFC-së të Standartit të Ekzekutimit No. 6 (Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore) për këtë projekt;
- (c) Marrjen në konsideratë ana e e IFC-së e e përputhjes së projektit me legjislacionin kombëtar; dhe
- (d) Zbatimin nga ana e e IFC-së e standarteve të konsultimit dhe të informimit për projektin.

Shqyrtimi para-investimor

Para kryerjes së një investimi, IFC ndërmerr një shqyrtim para-investimor M&S. Shqyrtimi para-investimor M&S i ndërmarrë nga IFC duhet të jetë "i përshtatshëm për natyrën dhe shkallën e projektit, dhe në proporcion me nivelin e rreziqeve dhe ndikimeve sociale dhe mjedisore" (Politika e Qëndrueshmërisë, para. 13). Në kryerjen e shqyrtimit M&S, IFC merr në konsideratë rreziqet M&S të përcaktuara nga klienti dhe "angazhimin dhe kapacitetet e klientit" për të menaxhuar këto rreziqe (Po aty., Para. 15). Një kërkesë kryesore e Politikës së Qëndrueshmërisë është se "IFC nuk financon një veprimtari të re biznesi që nuk mendohet të jetë në përputhje me standardet e Ekzekutimit përgjatë një periudhe të arsyeshme kohore" (para. 17).

Siç përshkruhet në Procedurën për Shqyrtimin M&S të IFC-së (PShMS), shqyrtimi M&S duhet të rezultojë në një Plan Veprimi Mjedisor dhe Social (PVMS) ku të trajtohen të gjitha mangësitë dhe mospërputhjet e konstatuara gjatë vlerësimit (PShMS3, para. 1.1).

Raporti Përmbledhës i Shqyrtimit M&S (RPSHMS) i IFC-së për projektin u paraqit në gusht 2011². RPSHMS u krye në bazë të shqyrtimit të "dokumenteve të brendshme që kanë të bëjnë me programin MSShS të sponsorit," intervistave me stafin e klientit dhe vizitave në vendin e projektit në Shqipëri.

RPSHMS fokusohet në kapacitetin e klientit për:

të kryer vlerësime të përshtatshme të ndikimit mjedisor dhe social dhe për të menaxhuar rreziqet mjedisore, sociale, shëndetësore dhe të sigurisë (MSShS), si dhe ndikimet që lidhen me blerjen, arkitekturën, ndërtimin dhe funksionimin e projekteve hidroenergjitike dhe objekteve të lidhura (p.sh. rruga e qasjes, linja e transmetimit), veçanërisht ato që kanë të bëjnë me menaxhimin e ndërtimit, përcaktimin e rrjedhës ekologjike dhe zbutjen e ndikimit në biodiversitet; dhe konsultimin dhe angazhimin efektiv të komuniteteve të prekura nga projekti.

Kjo metodologji është aplikuar për arsye se klienti pritej të zhvillonte disa projekte hidroenergjitike, në të cilat do të zbatonte standardet e ekzekutimit.

RPSHMS gjithashtu vë në dukje angazhimin e klientit për të vepruar në përputhje me "Standardet shqiptare dhe të IFC-së të ekzekutimit në lidhje me Qëndrueshmërinë Sociale dhe të Mjedisit si dhe me Udhëzimet përkatëse të IFC-së për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë (MShS)."

Përveç analizës së sistemit të menaxhimit M&S të klientit, RPSHMS përfshin një numër konstatimesh në lidhje me projektin e Lëngaricës, që do të ishte projekti i parë i zhvilluar nga klienti mbas investimit të IFC-së.

² Raporti Përmbledhës i Shqyrtimit M&S (RPSHMS) i IFC-së, gusht 2011 - <http://goo.gl/z6ZHsj>

Në lidhje me çështjet e ngritura nga ankuesit, RPSHMS deklaroi se klienti ka "shqyrtuar VNMS e mëparshme (Vlerësim i Ndikimeve Mjedisorë e Sociale) të përgatitur para përfshirjes së klientit, dhe ka azhornuar VNMS në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare të industrisë." Në përmbledhje të VNMS të azhornuar, RPSHMS vëren se lumi Lëngaricë është "një zonë me vlera të larta biodiversiteti" dhe se projekti do të shkaktojë rrjedhje të reduktuar të Lëngaricës në një seksion prej rreth 8 km. Rrjedha minimale e garantuar është përshkruar në nivelin 20% të rrjedhës minimale gjatë periudhave të thata (ose 0.2 m³/s). IFC gjithashtu vë në dukje konstatimin nga VNMS se "rrjedhja e mbetur e ujit ... mund të mbrojë funksione të ndryshme të lumit, duke ofruar habitate për bimët, kafshët e egra dhe speciet ujore."

Përsa i përket shqetësimit të ankuesve në lidhje me ndikimin e projektit mbi apelin turistik të zonës, RPSHMS thekson se klienti po e përgatit projektin në mënyrë të tillë që të minimizojë ndikimin mbi vlerën piktoreske të zonës, duke përfshirë edhe burimet e ujërave termale dhe urat e lashta.

Faqja e internetit e IFC paraqet një Plan Veprimi Mjedisor dhe Social për klientin, i cili u afishua në të njëjtën kohë me RPSHMS³. Në lidhje me projektin, kjo përfshinte kërkesat që klienti:

- të zbatojë Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe të Monitorimit Mjedisor dhe Social;
- të ruajë një rrjedhje të mbetur prej të 0.2m³/s të stabilizuar përgjatë gjithë vitit;
- të porosisi një raport që të tregojë se ndikimi në hidrogeologji (duke përfshirë edhe ndikimin mbi burimet gjeotermale) është i kufizuar; dhe
- të angazhojë një ekspert të pavarur biodiversiteti për të hartuar dhe menaxhuar zbatimin e një programi të konsiderueshëm për monitorimin e biodiversitetit.

As RPSHMS dhe as PVMS nuk përmendin vendndodhjen e projektit në një park kombëtar apo praninë e specieve të veçanta të rrezikuara në zonë. Megjithatë, PVMS përmend praninë e "specieve endemike të përfshira në "listën e kuqe" në rrezik zhdukjeje." Kjo referencë është marrë nga VNMS, i cili vë në dukje praninë e "llojeve të rralla dhe të rrezikuara" në këtë zonë, ku përfshihen specie të florës, amfibe dhe peshku, sidomos *Anguilla anguilla* (Ngjala Evropiane), e cila është përshkruar si e rrezikuar sipas Listës së Kuqe të Shqipërisë.⁴

Sipas shpjegimit që i është dhënë CAOs nga IFC, ekipi nuk ishte në dijeni se projekti ishte i vendosur në një park kombëtar në kohën e shqyrtimit M&S, për arsye se kjo nuk është identifikuar në VNMS e vitit 2011, megjithëse zona në fjalë është shpallur si pjesë e parkut kombëtar që në vitin 2008. Përsa i përket pranisë së *Anguilla anguilla*, IFC është e mendimit se megjithëse është raportuar prania e kësaj specieve, VNMS nuk ka paraqitur konkluzionin se projekti është i vendosur në një habitat kritik. Në këtë kontekst, IFC vë në dukje konkluzionet e VNMS se për shkak të pranisë së ujërave termale të Bënjës: "statusi ekologjik i segmentit të lumit të ndikuar nga projekti është 'i varfër' në afërsi të ujërave termale dhe 'i moderuar' në rrjedhën e poshtme në afërsi të lumit Vjosa." IFC gjithashtu vë në dukje se PVMS përfshinte një kërkesë për zhvillimin e një programi për monitorimin e biodiversitetit për të siguruar minimizimin e ndikimit në biodiversitet.

³ Enso Shqipëri, Plan Veprimi Mjedisor dhe Social, gusht 2011 - <http://goo.gl/M4YR0u>

⁴ *Anguilla anguilla* është klasifikuar që nga viti 2008 si "e rrezikuar në mënyrë kritike 'në Listën e Kuqe të BNRN për speciet e kërcënuara: <http://www.iucnredlist.org/search>. Një nga kërcënimet më të mëdha të popullsisë të ngjallës evropiane, siç përshkruhet nga BNRN janë" pengesat për migracionin përgjatë dhe kundër rrjedhës, ku përfshihen edhe vdekshmëria nga turbinat e hidrocentraleve."

Zbatimi i Standartit të Ekzekutimit No. 6

Përsa i përket zbatimit të Standartit të Ekzekutimit No. 6 (Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore), ankuesit pretendojnë se projekti: (a) ka ndikime negative në biodiversitetin në habitatet natyrore dhe kritike; (b) është e vendosur brenda zonave të mbrojtura me ligj dhe ndikon negativisht mbi to; dhe (c) ka ndikime negative në aktivitetet e ekoturizmit, të tilla si vozitjet me kajak dhe turnetë me udhërrëfyes në kanionin e Lëngaricës dhe vizitat në ujërat termale të Bënjës.

Në kohën e shpërndarjes së informacionit, IFC vuri në dukje se SE6 do të jetë i zbatueshëm për këtë projekt. Në lidhje me çështjet e ngritura nga ankuesit, SE6 parashikon si më poshtë

Për të shmangur dhe minimizuar ndikimet negative në biodiversitet në zonën e influencuar nga projekti, klienti do të vlerësojë rëndësinë e ndikimeve të projektit në të gjitha nivelet e biodiversitetit, si një pjesë integrale e procesit të Vlerësimit Social dhe Mjedisor. Vlerësimi do të marrë në konsideratë vlerat e ndryshme që i bashkangjiten biodiversitetit nga palë të interesuara të veçanta, si dhe do të identifikojë ndikimet mbi shërbimet e ekosistemit.⁵

SE6 përcakton kërkesa të ndryshme në varësi të llojeve të habitateve ku një projekt pritet të ketë ndikim. Habitatet natyrore, habitate kritike dhe zonat e mbrojtura përfitojnë mbrojtje të veçantë në bazë të Standartit të Ekzekutimit 6 (paragrafët 7-11).

Për habitatet natyrore, kërkesa është që projekti të mos konvertojë apo degradojë këto vendbanime, përveç rasteve kur: (a) nuk ka alternativa teknikisht dhe financiarisht të realizueshme; (b) përfitimet e përgjithshme të projektit tejkalojnë dëmet (duke përfshirë edhe ato të mjedisit dhe biodiversitetit); dhe (c) çdo konvertim apo degradim është zbutur në mënyrë të përshtatshme. Masat e nevojshme zbutëse janë përshkruar më tej si të konceptuara që kur është e mundur të mos krijohet asnjë humbje neto prej biodiversitetit dhe mund të përfshijnë restaurimin e habitateve, kompensimin e humbjeve dhe kompensim për përdoruesit e drejtpërdrejtë të biodiversitetit (paragrafët. 7 dhe 8).

Për projektet që ndikojnë në habitatet kritike dhe zonat e mbrojtura zbatohen standarde më të rrepta. Në këto rrethana SE6 e ndalon aktivitetin e projektit, përveç rasteve kur: (a) nuk ka ndikim të matshëm negativ në aspektet kritike të habitatit; dhe (b) nuk ka asnjë reduktim në popullsinë e asnjë specieje të njohur të rrezikuar të habitateve (paragrafët. 10 dhe 11).

Në përgjigje të këtyre kërkesave, IFC mendon se, në bazë të VNMS origjinale dhe studimeve të mëvonshme të porositura nga klienti, projekti nuk ndikon në ndonjë habitat kritik apo zonë të mbrojtur me ligj për të ruajtur biodiversitetin, siç përcaktohet në SE6. Ndërkohë që është pranuar se projekti do të ndryshojë dinamikën natyrore të lumit, IFC është e mendimit se në VNMS është identifikuar se rrjedha e mbetur, e cila do të mbahet konstante, do të jetë e mjaftueshme për të ruajtur funksionet ekologjike të lumit. IFC gjithashtu vë në dukje krijimin e një programi të monitorimit të biodiversitetit të konceptuar për të siguruar që vlerat e biodiversitetit në gjatësinë e lumit me rrjedhje të reduktuar të mos ndikohen negativisht. Monitorimi është përshkruar si mbështetje e një trajtimi adaptiv që do të siguronte ruajtjen e biodiversitetit në lumë në rast se projekti do të ketë një ndikim më të madh se sa pritej, ose sa është vënë re deri më tani.

⁵ Standarti i Ekzekutimit No. 6 i IFC, para. 4, Prill 2006

Përsa i përket ndikimit të projektit në turizëm, VNMS për projektin (2011) arrin në përfundimin se reduktimi i ujit në kanion do të ulë vlerat e tij turistike dhe të peisazhit natyror. Plani i Veprimit dhe Monitorimit Mjedisor dhe Social i klientit (2013) identifikon ndikimet e mundshme negative mbi ekoturizmin dhe rekomandon monitorimin e tyre. Dokumentacioni mbikëqyrës i IFC-së përfshin një Vlerësim të Ndikimit mbi Turizmin (2014), ku arrihet në përfundimin se pavarësisht se projekti do të ketë një ndikim negativ në disa aktivitete turistike (si vozitja me kajak në Lëngaricë), ai do të ketë një ndikim të përgjithshëm progresivisht pozitiv mbi zhvillimin e turizmit në këtë zonë. IFC thekson se natyra e projektit është e tillë që do të sjellë ndikim minimal vizual mbi peizazhin. IFC vë në dukje gjithashtu angazhimin e klientit për rehabilitimin dhe ripyllëzimin mbas ndërimit, gjë që do të sjellë vlera pozitive nga pikëpamja rikrijuese dhe do të sigurojë mundësinë e përdorimit të burimeve termale. Përveç kësaj, IFC vë në dukje një numër aktivitete që kanë të bëjnë me Përgjegjësinë Korporative Shoqërore të cilat po zbatohen nga klienti për të restauruar monumentet kulturore në afërsi. Së fundi, IFC vë në dukje studimet e ndërmarra për të siguruar që projekti nuk do të ndikojë mbi burimet termale në zonë, të cilat përdoren nga turistët dhe vendasit.

Informimi dhe angazhimi i palëve të interesuara

Ankuesit ngrenë shqetësime në lidhje me përshtatshmërinë e shpërndarjes së informacionit mbi projektin nga ana e klientit. Ata gjithashtu pretendojnë se metodologjia e klientit për konsultim nuk ishte kuptimplotë.

Publikimi i dokumenteve të vlerësimit dhe planeve të veprimit M&S, si dhe azhurnimet mbi progresin e bërë në lidhje me planet e veprimit janë detyrime të klientit (SE1, parag. 20 dhe 26). Përveç kësaj, IFC duhet të publikojë "kopje elektronike të [...] të gjitha dokumentet përkatëse të vlerësimit të ndikimit M&S të përgatitura nga ose në emër të klientit [...]" para bërjes publike të projektit nga IFC.⁶

Siç kërkohet nga SE1, angazhimi i komunitetit duhet të bëhet në bazë të "[...], informacion të dhënë në kohën e duhur, të përshtatshëm, të kuptueshëm dhe të mundshëm për t'u marrë" (para. 19). Proçesi i konsultimit duhet të sigurojë "komunitetet e prekura me mundësi për të shprehur pikëpamjet e tyre mbi rreziqet e projektit, ndikimet dhe masat zbutëse [...]".⁷ Konsultimet efektive, shpjegon SE1 "[...] duhet të bazohen në shpërndarjen paraprake të informacionit përkatës dhe të përshtatshëm, duke përfshirë draftet e dokumenteve dhe planeve [...]" dhe duhet të jetë "i adoptuar [...] për preferencat gjuhësore të komuniteteve të prekura".⁸

CAO vë në dukje se as IFC as kompania nuk e kanë publikuar VNMS në faqet e tyre të internetit. Sipas RPSHMS, VNMS u bë publike në Shqipëri në gusht 2011 për dy institucione shtetërore: QKL (Qendra Kombëtare e Liçensimit) dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave. RPSHMS thekson gjithashtu se VNMS "po bëhet publike për komunitetet e prekura nga [klienti]." Dokumentacioni M&S i hartuar nga klienti është i listuar në faqen e internetit të klientit,⁹ por nuk është bërë publik, me përjashtim të Planit të Veprimit dhe Monitorimit Mjedisor dhe Social (2013), i cil është publikuar në anglisht.

Përsa i përket metodologjisë së klientit për angazhimin e palëve të interesuara, IFC thekson se në 2011 u organizua një takim konsultativ në kuadrin e përgatitjes së VNMS. IFC thekson se janë ngritur zyra lokale informacioni në Përmet dhe se është caktuar një oficer për lidhje me

⁶ Politika për Shpërndarjen e Informacionit, para. 13, prill 2006

⁷ Standarti i Ekzekutimit 1 i IFC, para. 21, prill 2006

⁸ Standarti i Ekzekutimit 1 i IFC, para. 21, prill 2006

⁹ <http://www.Enso.at/referenzen/projekte/detail/lengarica/>

komunitetin. IFC gjithashtu vë në dukje aktivitetet e informimit publik të organizuara nga klienti në kryeqytet, Tiranë, në vitin 2014 dhe 2015.

Pajtueshmëria me legjislacionin kombëtar

IFC kërkon që projektet që mbështet jo vetëm të plotësojnë kërkesat e standardeve të saj të ekzekutimit por të jenë edhe në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm kombëtar (Standardet e Ekzekutimit (2006) Hyrje, para. 3).

Ankuesit pretendojnë se projekti nuk i plotëson kërkesat ligjore shqiptare. Përkatësisht, ata pretendojnë se ndërtimi i tij bie në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit shqiptar mbi zonat e mbrojtura dhe kuadrin e zonimit për Parkun Kombëtar të Bredhit të Hotovës, në të cilin ai ndodhet. Në këtë kontekst, ankuesit theksojnë se në tetor të vitit 2011 Ministria e Mjedisit ia ka mohuar autorizimin klientit për projektin, në bazë të vendndodhjes së tij në brendësi të Parkut Kombëtar dhe në një zonë të mbrojtur të monumenteve kombëtare.

Në përgjigje të këtij problemi, IFC thekson se Ministria e Mjedisit e ka miratuar projektin në janar 2012 pas dorëzimit të informacionit shtesë nga ana e klientit. IFC gjithashtu thekson se Parku Kombëtar është i ndarë në 4 zona dhe se projekti është i vendosur jashtë zonës qendrore, dhe ndodhet në zona e zonuara për: shfrytëzim të qëndrueshëm, tradicional, dhe rekreativ. IFC gjithashtu vë në dukje një shqyrtim të kuadrit ligjor të porositur nga klienti i cili arrin në përfundimin se projekti është lejuar në mënyrë të korrekte.

Konkluzion

Ky vlerësim i pajtueshmërisë shqyrton një ankesë në lidhje me ndikimet mjedisore dhe sociale të projektit hidroelektrik Lëngaricë. Mbas marrjes në konsideratë të çështjeve të ngritura nga ankuesit dhe një rishikimi të dokumentacionit në dispozicion, CAO ka identifikuar një numër shqetësimesh në lidhje me shqyrtimin dhe mbikëqyrjen e projektit nga ana e IFC-së. Së pari, CAO është i paqartë nëse shqyrtimi para-investimor i VNMS së klientit nga ana e IFC-së ishte proporcional me rrezikun, veçanërisht në lidhje me ndikimet e mundshme të projektit mbi biodiversitetin. Së dyti, duke patur parasysh vendndodhjen e projektit brenda një parku kombëtar, dhe identifikimin e specieve të rralla dhe/apo të rrezikuara në zonë, CAO është i paqartë nëse IFC ka zbatuar me përpikmëri për projektin aspektet e SE6 të cilat kanë të bëjnë me lloje të posaçme specimesh të habitateve dhe zonave të mbrojtura. Së treti, nuk është e qartë nga dokumentacioni në dispozicion që IFC ka aplikuar si duhet kërkesat e saj për dhënien e informacionit dhe konsultimet për këtë projekt.

Përcaktimi i rolit të IFC-së në vlerësimin e pajtueshmërisë së projektit me legjislacionin kombëtar është pak i vështirë, po të kemi parasysh se institucionet kombëtare kanë juridiksion për marrjen e vendimeve në lidhje me përputhje me legjislacionin kombëtar. Në këtë rast, CAO vë në dukje se mbikëqyrja e referencave të projektit nga ana e IFC-së i referohet: (a) një lejeje nga Ministria e Mjedisit të Shqipërisë që autorizon ndërtimin e projektit; dhe (b) një shqyrtim të kuadrit ligjor të çështjes të porositur nga klienti. Në mungesë të provave alternative, CAO konkludon se mbikëqyrja e problemit të pajtueshmërisë ligjore nga ana e IFC-së ishte e përshtatshme.

IV. Vendimi i CAO

Vendimi nëse CAO duhet të nisë një hetim të pajtueshmërisë kërkon peshimin e faktorëve që përfshijnë ndikimin e mundshëm M&S të një projekti, një vlerësim paraprak të punës së IFC

'kundrejt kërkesave M&S, si dhe një vlerësim më të përgjithshëm të përshtatshmërisë së kërkesave M&S të IFC-së në kontekstin e çështjeve të ngritura në një ankesë.

Është pranuar që ky projekt është i vendosur në një park kombëtar. Është pranuar gjithashtu që projekti është i vendosur në një zonë me vlera të larta biodiversiteti dhe habitate të pasura. Për më tepër, në zonën e projektit është identifikuar një specie e përfshirë në Listën e Kuqe (rrezikuar në mënyrë kritike) të BNRN, *Anguilla anguilla*.

Habitatet natyrore, habitate kritike dhe zonat e mbrojtura përfitojnë mbrojtje specifike sipas Standartit të Ekzekutimit 6 (Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Burimeve Natyrore të Qëndrueshme). Në këtë kontekst, CAO vë në dukje pikëpamjen e IFC-së se projekti nuk ndikon mbi habitatet kritike dhe nuk është e vendosur në një zonë të caktuar me ligj për mbrojtjen apo ruajtjen e biodiversitetit. CAO gjithashtu vë në dukje pikëpamjen e IFC-së se projekti është konceptuar për të minimizuar ndikimet negative në biodiversitet dhe terrenet lokale me rëndësi nga pikëpamja e trashëgimisë kulturore dhe skenike.

Megjithatë, CAO konstaton se ankesa ngre probleme të rëndësishme që lidhen me vlerësimin dhe mbikëqyrjen e ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit nga ana e IFC-së. Këto përfshijnë pyetje të tilla si më poshte:

- a. Nëse shqyrtimi para-investimor i standardeve M&S të projektit nga ana e IFC-së, dhe sidomos shqyrtimi i ndikimit të tij të mundshëm mbi biodiversitetin dhe shërbimet e ekosistemit ishte proporcional me rrezikun.
- b. Nëse IFC siguroi zbatimin e përshtatshëm të Standartit të Ekzekutimit No. 6 për këtë projekt, sidomos po të mbahet parasysh vendndodhja e projektit në një park kombëtar dhe prania e specieve të rralla dhe/apo të rrezikuara në këtë zonë; dhe
- c. Nëse IFC siguroi zbatimin e përshtatshëm të standardeve të saj të konsultimit dhe të informimit për projektin.

Zgjidhja e problemeve të mësipërme kërkon marrjen në konsideratë në mënyrë të hollësishme dhe përfshirjen e ekspertizës teknike përkatëse. Si rezultat, CAO ka identifikuar nevojshmërinë e kryerjes së një hetimi të pajtueshmërisë. Termat e referencës të hetimit të pajtueshmërisë do të përgatiten në përputhje me Udhëzimet Operative të CAO.